FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 61 **Datë 30 prill 2014**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 220, datë 23.4.2014	Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve nga Ministria e Kulturës te Komiteti Shtetëror i Minoriteteve dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile……	2343
Vendim i KM nr. 223, datë 23.4.2014	Për miratimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë……	2345
Vendim i KM nr. 224, datë 23.4.2014	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kroacisë, për partneritetin europian……	2347
Vendim i KM nr. 225, datë 23.4.2014	Për miratimin e protokollit për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Moldavisë, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar……	2349
Vendim i KM nr. 226, datë 23.4.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar……	2355
Vendim i KM nr. 227, datë 23.4.2014	Për mbylljen e konsullatës së përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Nju-Jork dhe hapjen e Zyrës Konsullore pranë Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës……	2355

Vendim i KM nr. 228, datë 23.4.2014	Për miratimin e strukturës dhe të organikës për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar……	2356
Vendim i KM nr. 229, datë 23.4.2014	Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit……	2359
Vendim i KM nr. 230, datë 23.4.2014	Për përbërjen dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit……	2362
Vendim i KM nr. 231, datë 23.4.2014	Për miratimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme, për periudhën 1 janar - 15 qershor 2014 dhe 15 shtator 2014 - 31 dhjetor 2014, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit……	2363
Vendim i KM nr. 232, datë 23.4.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 945, datë 9.10.2013 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit"……	2364
Vendim i KM nr. 234, datë 23.4.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 239, datë 27.3.2013 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e mënyrës së re të përdorimit të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit"……	2364
Vendim i KM nr. 239, datë 28.4.2014	Për shlyerjen e detyrimit doganor të prapambetur të Ministrisë së Mbrojtjes ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave……	2364

VENDIM
Nr. 220, datë 23.4.2014

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA MJEDISEVE NGA MINISTRIA E KULTURËS TE KOMITETI SHTETËROR I MINORITETEVE DHE AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve në katin e tretë të godinës së ish-shtëpisë botuese "Naim Frashëri", Tiranë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës, te Komiteti Shtetëror i Minoriteteve dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për t'u përdorur si mjedise pune nga këto institucione, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Këtyre institucioneve u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen ministri i Kulturës, Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe kryeregjistruesi i Zyrës për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama




PLANI KATIT DYTË DHE TË TRETË E TRETË SHK 1:100
MINISTRIA E ARSIMIT
SATYPSHKRONJË E RE
Tiranë
PLANI KATIT DYTË, TRETË 1:100
KONTROLL TEKNIK

VENDIM
Nr. 223, datë 23.4.2014

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES KUADËR, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR BASHKËPUNIMIN NË NXITJEN DHE LEHTËSIMIN E TREGTISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJEJE KUADËR
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR BASHKËPUNIMIN NË NXITJEN DHE LEHTËSIMIN E TREGTISË

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, më poshtë referuar si "Palët",

Duke pasur dëshirën për të nxitur dhe lehtësuar tregtinë ndërmjet dy vendeve;

Me objektivin për të thjeshtëzuar dhe harmonizuar legjislacionin tregtar;

Duke kuptuar që aplikimi më i gjerë i kontrolleve me bazë risku, do të lejonin reduktimin e shpeshtësisë dhe intensitetit të ekzaminimeve fizike, dhe, kështu do të lejonin reduktimin e kohës së kalimit në kufi dhe të zhdoganimit të mallrave;

Duke kuptuar që lehtësimi i proceseve të zhdoganimit brenda vendit dhe në kufi kërkon bashkëpunim efikas dhe harmonizim të procedurave jo vetëm ndërmjet autoriteteve të doganave të Palëve, por edhe ndërmjet autoriteteve jodoganore përgjegjëse për kontrollet fitosanitare, veterinare dhe kontrollet për sigurinë e produkteve ushqimore dhe joushqimore në mbrojtje të konsumatorëve, respektimin e legjislacionit për pronësinë intelektuale;

Duke pasur angazhimin për të qenë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, duke përfshirë Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT), Konventën e Rishikuar të Kyotos, Konventën Ndërkombëtare mbi Harmonizimin e Kontrollit Kufitar të Mallrave (Konventa e Gjenevës);

Me qëllim që të sigurohet zbatimi efikas i dispozitave të Marrëveshjes CEFTA,

Pa rënë ndesh me legjislacionin e të dy vendeve dhe atëherë kur është e mundur nga pikëpamja teknike,

ranë dakord për sa më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Sipas qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje do të aplikohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Transit" përmes territorit të Republikës së Shqipërisë (Republikës së Kosovës)" do të thotë kalim përmes kontrollit doganor nga zyra doganore e Republikës së Shqipërisë (Republikës së Kosovës) deri te zyra doganore e Republikës së Kosovës (Republikës së Shqipërisë).

2. "Autoritetet UV dhe SFS" u referohet institucioneve përkatëse të Palëve përgjegjëse për kontrollet veterinare, ushqimore, sanitare dhe fitosanitare, dhe kontrollin e sigurisë gjatë importit, eksportit dhe transitit të mallrave.

Neni 2
Fushat e bashkëpunimit

1. Për lehtësimin e transitit të mallrave nëpër territoret e tyre dhe rritjen e kapaciteteve të tyre për transit, Palët duhet të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

a) Harmonizimin gradual të legjislacionit dhe standardeve në fushën e sigurisë së produkteve ushqimore dhe joushqimore, shëndetit të bimëve dhe kafshëve me interes të ndërsjellë;

b) Harmonizimin e legjislacionit për masat mbrojtëse në importet dhe *antidumping*;

c) Harmonizimin e legjislacionit në fushën e pronësisë intelektuale;

d) Përshpejtimin e masave të organeve akredituese të dy vendeve për nënshkrimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe me Organizatën Europiane të Akreditimit fillimisht në fushën e laboratorëve testues dhe në të gjithë fushat e tjera;

e) Krijimin e mekanizmave të informimit dhe të lajmërimit reciprok në rastet e produkteve që nuk plotësojnë kërkesat e sigurisë dhe të legjislacionit të pronësisë intelektuale;

f) Shkëmbimin e informacionit, të dokumentacionit dhe ndërveprimin e sistemeve elektronike të doganave;

g) Harmonizimin dhe thjeshtëzimin e procedurave të transitit;

h) Zhvillimin/përmirësimin e sistemit të deklarimit në doganë;

i) Palët mund të negociojnë dhe të shtojnë fusha të tjera, siç kërkohet për përmbushjen efektive të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Shkëmbimi i informacionit, i dokumentacionit dhe ndërveprimi i sistemeve elektronike

1. Për të siguruar shkëmbim efikas të informacionit në lidhje me transitin, si dhe ndërveprim efektiv të sistemeve përkatëse elektronike, Palët:

a) Do të harmonizojnë dhe standardizojnë informacionet dhe të dhënat referencë (*reference data*), si dhe dokumentacionin përkatës në formatet respektive, me qëllim shkëmbimin e tyre ndërmjet doganave dhe autoriteteve UV dhe SFS të Palëve;

b) Do të identifikojnë dhe shfrytëzojnë mundësitë për një përdorim më të gjerë të shkëmbimit elektronik të dokumenteve dhe reduktim të kërkesave për dokumente në letër (joelektronike).

2. Palët do të ndërmarrin hapa për t'u siguruar që autoritetet FV dhe SPS të kenë qasjen e duhur në informacionin paraprak (para mbërritjes) dhe informacionet e tjera përkatëse për ngarkesën që po importohet, eksportohet apo transitohet. Doganat dhe autoritetet UV dhe SFS do të punojnë bashkërisht për të vendosur sisteme dhe mekanizma efikasë për të pasur një qasje të tillë në informacion.

3. Palët do të ndërmarrin hapa për të siguruar këmbimin e informacionit të standardizuar për produktet joushqimore që paraqesin rrezik për sigurinë dhe shëndetin e konsumatorëve / përdoruesve, harmonizimin e metodologjive për vlerësimin e riskut dhe komunikimin e tij.

4. Palët do të ndërmarrin hapa për të siguruar këmbimin e informacionit për një mbrojtje të plotë dhe efektive të të drejtave të pasurisë intelektuale, përfshirë, në veçanti, mbrojtje të plotë dhe efektive të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të ngjashme me to, markës tregtare, treguesve gjeografikë, patentave pa diskriminim, ashtu si edhe në fushën e shpikjeve, projektimeve industriale, topografisë së qarqeve të integruara dhe informacion të pakufizuar mbi *know how*.

5. Palët do të shkëmbejnë informacione dhe do të koordinojnë aktivitetet e tyre që kanë si synim zhvillimin/përmirësimin e sistemeve të tyre elektronike, me qëllim që të shmangin vështirësitë e mundshme, që kanë të bëjnë me ndërveprimin e sistemeve përkatëse.

6. Palët angazhohen të identifikojnë terminalet për zhvillimin e transportit intermodal, që do të shërbejë për të dyja vendet.

Neni 4

Harmonizimi dhe thjeshtëzimi i procedurave të transitit

1. Për lehtësimin e procesit të transitit ndërmjet vendeve të tyre, Palët do të harmonizojnë dhe do të thjeshtëzojnë dispozitat përkatëse në legjislacionet e tyre, dhe do të harmonizojnë e do të bëjnë më të efektshme procedurat përkatëse të procesit të transitit, e në mënyrë të veçantë:

a) Palët do të bëjnë rregullimet e nevojshme për të siguruar procedura të garantuara efikase dhe të thjeshtëzuara gjatë transitit, me qëllimin që të përdoret një garanci në vend të dy;

b) Palët do të bëjnë rregullimet e nevojshme për të shmangur dublikimin, aty ku është më praktike, dhe për të siguruar procedura eficiente dhe të thjeshtëzuara të transitit, si: peshimi i kamionëve, plumbosja e kamionëve, fillimi dhe përfundimi i transitit, rakordimi i informacionit në hyrje dhe dalje nga doganat e territoreve të tyre, dhe lëshimi, shlyerja dhe aktivizimi i garancive.

c) Palët do të bëjnë rregullimet e nevojshme për të siguruar eliminimin e çmimeve arbitrare të referencës.

d) Palët duhet të bëjnë përpjekje për harmonizimin e procedurave të akreditimit dhe njohjen reciproke të certifikatave të akreditimit, raporteve të testimit si rregullime për të arritur njohjen reciproke të rezultateve të vlerësimit të përputhshmërisë nga autoritetet e tyre UV dhe SFS të përfshira në transit, dhe importin/eksportin e mallrave.

e) Palët mund të negociojnë dhe të shtojnë fusha të tjera për t'u harmonizuar dhe bërë më të efektshme për arritjen e suksesshme të kësaj Marrëveshjeje.

2. Për reduktimin e kohës së kalimit në kufi, Palët do të bëjnë përpjekje të përbashkëta për të arritur aplikim më të gjerë të kontrolleve, bazuar në risk, në mënyrë të veçantë, në kontrollet UV dhe SFS, si dhe për eliminimin e barrierave të panevojshme teknike në tregti për produktet joushqimore, duke reduktuar shpeshtësinë dhe intensitetin e ekzaminimeve fizike të ngarkesave në transit (dhe import/eksport). Në mënyrë të veçantë, Palët:

a) Do të sigurohen që legjislacionet e tyre përkatëse përfshijnë dispozita të cilat lejojnë zbatimin e kontrolleve me bazë risku të harmonizuara me metodologjitë europiane të vlerësimit dhe të menaxhimit të riskut. Në këtë aspekt, Palët do të marrin masat e nevojshme për të rishikuar dhe amenduar ligjet dhe rregulloret përkatëse, sipas kërkesës.

b) Do të bazuar në vlerësimin e riskut dhe zhvillimin e kritereve korresponduese për menaxhimin e riskut (kategorizimin e produkteve dhe/ose tregtarëve), do të identifikojnë mundësi për t'i lëvizur kontrollet UV dhe SFS të importeve, sa më shumë të jetë e mundur, nga PKK-të në terminalet në brendësi të vendit apo ambientet e tregtarëve. Pilotimi me produktet dhe/ose tregtarët me risk të vogël mund të jetë një mënyrë eficiente zbatimi.

c) Bazuar në vlerësimin e riskut dhe zhvillimin e kritereve korresponduese, do të bëjnë përpjekje për të aplikuar më gjerë procedura të thjeshtuara të zhdoganimit për produktet dhe/ose tregtarët me risk të vogël.

d) Do të bashkëpunojnë për të siguruar nivel të përshtatshëm të kapaciteteve të punonjësve doganorë, autoriteteve UV dhe SFS, të mbikëqyrjes së tregut për produktet joushqimore dhe mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe pronësisë industriale në aspektet praktike të menaxhimit të riskut (veçanërisht, vlerësimi i riskut dhe profilizimi).

e) Do të krijojnë skema eficiente për shkëmbimin e informacioneve që lidhen me riskun ndërmjet sistemeve të tyre elektronike të zhdoganimit, dhe, aty ku është praktikë, do të identifikojnë dhe përdorin mundësitë për profilizimin e përbashkët të riskut, dhe për të zhvilluar modulet e vlerësimit të riskut.

Neni 5
Zhvillimi/përmirësimi i sistemit të deklarimit në doganë

1. Palët do të ndërmarrin hapa praktikë për të siguruar nivelin e përshtatshëm të zhvillimit të sistemit të deklarimit në doganë dhe cilësinë e shërbimit të agjentëve doganorë, në mënyrë të veçantë:

a) Do të koordinojnë veprimet dhe përpjekjet në prezantimin e problematikave, si dhe në njehsimin e standardeve dhe kërkesave për agjentë doganorë, duke përfshirë, mes aktiviteteve të tjera, trajnime të përbashkëta;

b) Do të koordinojnë veprimet për shkëmbimin dhe harmonizimin e informacionit për agjentët doganorë sipas rregullave respektive.

Neni 6
Zbatimi

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të krijohen grupe të përbashkëta pune në nivel teknik për eliminimin gradual të barrierave jotarifore në tregti, për:

a) barrierat teknike në tregti;

b) masat sanitare, fitosanitare dhe veterinare;

c) barrierat administrative, veçanërisht doganore.

Grupet do të identifikojnë barrierat tregtare jotarifore dhe do të propozojnë masa për eliminimin e tyre me afate kohore të përcaktuara.

2. Grupet e punës do të krijohen brenda 1 (një) muaji nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Grupet e punës do të bien dakord për termat e referencës së aktiviteteve, brenda 3 (tre) muajve nga krijimi i tyre.

Neni 7
Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, me të cilin palët kanë njoftuar njëra-tjetrën, se janë plotësuar kërkesat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje është siguruar për një periudhë të pakufizuar kohore; megjithatë, secila nga Palët mund ta shpallë të pavlefshme atë në çdo kohë, me anë të një njoftimi nëpër kanalet diplomatike. Përfundimi i saj do të hyjë në fuqi tre muaj pas dërgimit të njoftimit për ta shpallur atë të pavlefshme te Pala tjetër. Rastet e pazgjidhura ende, në momentin e përfundimit, do të zgjidhen në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

3. Palët do të takohen për të rishikuar këtë Marrëveshjeje, sipas kërkesës ose pas dy vjetësh pas datës së hyrjes në fuqi të saj, nëse Palët nuk e informojnë njëra-tjetrën me shkrim që një rishikim i tillë është i panevojshëm.

Bërë në Prizren, më 11 janar 2014, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe dhe serbe, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhje në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën shqipe.

VENDIM
Nr. 224, datë 23.4.2014

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË, PËR PARTNERITETIN EUROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për partneritetin europian, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË MBI PARTNERITETIN EUROPIAN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë (më poshtë të quajtura "Palët Kontraktuese"),

Duke dëshiruar forcim të mëtejshëm të marrëdhënieve të tyre të mira dypalëshe, të bazuara në barazi dhe respekt reciprok, dhe duke i zgjidhur çështjet e hapura në frymën e miqësisë, partneritetit dhe besimit të ndërsjellë;

Duke qenë të vetëdijshme për rëndësinë e kontributit të tyre për paqe, stabilitet dhe progres në Europën Juglindore, dhe të bindur se zbatimi i reformave të lidhura me Bashkimin Europian kontribuon në afirmimin e qëndrueshëm të këtyre vlerave;

Duke shprehur rëndësinë e qasjes individuale në vlerësimin e pranueshmërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

Duke marrë në konsideratë vendosmërinë e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e reformave për përafrimin e legjislacionit të saj dhe të standardeve me ato të Bashkimit Europian dhe gatishmërinë e Qeverisë së Republikës së Kroacisë për t'i ofruar Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbështetjen e duhur teknike dhe politike,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese janë të vendosura të ndërtojnë dhe të zhvillojnë partneritet europian që do të kontribuojë në integrimin europian të Republikës së Shqipërisë dhe të afirmojë vlerat europiane në bashkëpunimin dypalësh dhe rajonal, duke stabilizuar më tej hapësirën e Europës Juglindore.

Bashkëpunimi, brenda kuadrit të partneritetit europian synon:

- Të ofrojë asistencë dhe të lehtësojë rrugën e bashkimit të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Europian, duke ofruar përvojën dhe njohuritë specifike të përftuara gjatë proceseve të integrimit Europian të Republikës së Kroacisë;
- Të kontribuojë për përafrim efektiv të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Europian, veçanërisht në lidhje me prioritetet e këtij procesi;
- Të lehtësojë përshtatjen e infrastrukturës institucionale të administratës shtetërore dhe ndërtimin e kapaciteteve të punonjësve të shërbimit civil në çështjet që i përkasin Bashkimit Europian;
- Të asistojë për zhvillimin e një procesi që i ofron publikut informacion në kohë e cilësor për reformat që lidhen me Bashkimin Europian;
- Të sigurojë asistencë për institucionet shqiptare mbi mënyrën e menaxhimit të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian.

Neni 2

Qeveria e Republikës së Kroacisë do të ofrojë njohuritë specifike, përvojën dhe ekspertizën e përftuar në procesin e integrimit europian në format e mëposhtme të bashkëpunimit:

- Organizim të konsultimeve të përbashkëta, iniciativave, eventeve dhe aktiviteteve;
- Organizim të vizitave studimore të ekspertëve nga Republika e Shqipërisë në institucione të Republikës së Kroacisë;
- Trajnime të avancuara nëpërmjet seminareve mbi çështje të integrimit europian, legjislacionin, ndërtimin e institucioneve dhe kapaciteteve, duke përfshirë ekspertë nga të dyja Palët Kontraktuese;
- Shkëmbim të punonjësve të shërbimit civil në fushat që i përkasin bashkëpunimit për çështje të lidhura me Bashkimin Europian;
- Ofrim i shërbimeve të ekspertizës nga ekspertë kroatë në fushën e integrimit europian;
- Trajnime dhe ndarje të eksperiencës mbi menaxhimin e mbështetjes financiare të Bashkimit Europian.

Neni 3

Palët Kontraktuese do të përgatisin projekte të përbashkëta me synimin për të aplikuar për fonde të mundshme nga Bashkimi Europian.

Neni 4

1. Për të monitoruar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të krijojnë një Komision të Përbashkët të përbërë prej përfaqësuesish të Palëve Kontraktuese, për të përgatitur programe të zbatimit, bashkëpunimit dhe për të përcaktuar nga afër operacionet dhe aktivitetet e propozuara në fushat e përmendura në këtë Marrëveshje.

2. Në përcaktimin e programeve të zbatimit, Komisioni i Përbashkët do të marrë parasysh marrëveshjet ekzistuese dypalëshe dhe efektet e tyre në marrëdhëniet ndërmjet Palëve Kontraktuese.

3. Palët Kontraktuese, nëpërmjet Komisionit të Përbashkët, do të shqyrtojnë dhe do të kërkojnë, gjithashtu, zgjidhje për çështje që mund të lindin në marrëdhëniet ndërmjet tyre si rezultat i aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian.

4. Palët Kontraktuese do të emërojnë përfaqësuesit e tyre në Komisionin e Përbashkët brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

5. Komisioni i Përbashkët do të takohet të paktën një herë në vit ose me kërkesë të cilësdo Pale Kontraktuese, në mënyrë alternative në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kroacisë. Mbledhja e parë e Komisionit të Përbashkët do të zhvillohet brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Të gjitha aktivitetet, projektet dhe bashkëpunimi i planifikuar dhe i kryer bazuar në këtë Marrëveshje do të harmonizohet me objektivat dhe vlerat e Bashkimit Europian.

Neni 6

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit të bërë nga Palët Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike, ku të njoftohet se janë përmbushur kërkesat e brendshme përkatëse ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë, me pëlqim të ndërsjellë me shkrim të të dyja Palëve Kontraktuese. Amendimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me parashikimet e paragrafit 1 më sipër.

3. Kjo Marrëveshje është lidhur për një periudhë të pakufizuar kohe. Secila Palë Kontraktuese mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje në çdo kohë, nëpërmjet një njoftimi me shkrim të drejtuar Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, Marrëveshja do të përfundojë 6 (gjashtë) muaj nga data në të cilën Pala tjetër Kontraktuese ka marrë njoftimin me shkrim për përfundimin e Marrëveshjes.

4. Përfundimi i Marrëveshjes nuk do të cenojë përfundimin e programeve dhe projekteve të rëna dakord dhe që janë në zhvillim në momentin e përfundimit, përveç kur Palët Kontraktuese bien dakord ndryshe.

5. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet Palëve Kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Bërë në Zagreb, më 21 mars 2014, në dy tekste origjinale, secili në gjuhët shqipe, kroate dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM
Nr. 225, datë 23.4.2014

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MOLDAVISË, PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PROTOKOLL
MBI ZBATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MOLDAVISË, PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Moldavisë (më poshtë të quajtura "Palë"),

Me dëshirën për marrjen e masave ose zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë për Ripranimin e Personave, të nënshkruar në Bukuresht, më 18.10.2013, më poshtë e quajtur "Marrëveshja",

Në përputhje me nenin 12 të Marrëveshjes,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Autoritetet kompetente

1. Autoritetet e mëposhtme kanë kompetencën të dërgojnë dhe të pranojnë kërkesa në lidhje me ripranimin e qytetarëve dhe të huajve të shteteve të Palëve:

2. a) Për Palën Shqiptare:
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin,
Drejtoria e Migracionit dhe Ripranimeve
Tel/faks: + 355 4 22 69 32
Tel: +355 4 2279 251, +355 4 22 79 241;
+355 4 22 79 279
Fax: +355 4 22 79 263
Adresa: bulevardi "Bajram Curri", Tiranë, Shqipëri.
E-mail: policiakufitare.migracioni@asp.gov.al
b) Për Palën Moldave:
Ministria e Punëve të Brendshme,
Drejtoria për Emigracionin dhe Azilin
Adresa postare: Stefan cel Mare 124 str
Tel/faks: +373 22 272487/203
E-mail: readmission@bma.gov.md

3. Autoritetet e mëposhtme kanë kompetencën të dërgojnë dhe të pranojnë kërkesa në lidhje me kalimin transit të të huajve në territorin e një Shteti të tretë:

a) Për Palën Shqiptare:
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin,
Drejtoria e Migracionit dhe Ripranimeve
Tel/faks: + 355 4 22 69 32
Tel: +355 4 2279 251, +355 4 22 79 241;
+355 4 22 79 279
Fax: +355 4 22 79 263

Adresa: bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë Shqipëri.
E-mail: policiakufitare.migracioni@asp.gov.al
b) Për Palën Moldave:
Ministria e Punëve të Brendshme,
Drejtoria për Emigracionin dhe Azilin
Adresa postare: Stefan cel Mare 124 str
Tel/faks: +373 22 272487
Tel/faks: +373 22 272203
E-mail: readmission@bma.gov.md

Neni 2
Provat e hyrjes dhe të qëndrimit të paligjshëm

1. Dokumentet e mëposhtme provojnë hyrje apo qëndrim të paligjshëm:

a) Dokumenti i udhëtimit që nuk ka vulën e hyrjes ose vulën korresponduese;

b) Pasaportë false ose e falsifikuar me vulën e hyrjes;

c) Çdo dokument tjetër udhëtimi që konfirmon hyrjen nëpërmjet kufirit të shtetit të palës së kërkuar dhe/ose për qëndrimin e paligjshëm.

2. Në veçanti, hyrja ose qëndrimi i paligjshëm mund të pranohen në bazë të pikave të mëposhtme:

a) Deklaratë, në formën e protokollit, e personit për ripranim, dërguar autoriteteve të Palës Kërkuese;

b) Deklaratë me shkrim e përfaqësuesve të autoriteteve;

c) Dokumente që sigurojnë akses në shërbimet publike dhe private në territorin e Palës së Kërkuar (kartat e sigurimit shëndetësor, dokumente për përfitime sociale, fatura të shërbimeve të përdorura etj.);

d) Të dhëna që tregojnë se personi që do të ripranohet, ka përfituar nga shërbimet e një agjenti udhëtimesh/ose të angazhuar në transportimin e pasagjerëve, i cili operon në territorin e Palës Kërkuese;

e) Biletat e udhëtimit;

f) Kontrolli i të dhënave në një sistem të dhënash kompjuterike;

3. Kur mundësohen dokumentet e renditura në seksionin 2, Pala e Kërkuar mund të kryejë kontrolle shtesë.

Neni 3
Aplikimet për ripranimin e shtetasve

1. Kërkesa për ripranim sipas nenit 2 të Marrëveshjes bëhet me shkrim dhe përmban:

a) Emrin dhe adresën e autoritetit kompetent të Palës Kërkuese, numrin e dosjes dhe datën e paraqitjes së kërkesës;

b) Emrin dhe adresën e autoritetit kompetent të Palës së Kërkuar;

c) Një tekst hyrës, si më poshtë: “Ka arsye që na bëjnë të besojmë se personi i identifikuar sa më poshtë, mbulohet nga dispozitat e nenit 2 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë mbi Ripranimin e Personave dhe kërkesën se ky person është pranuar në territorin e (Republikës së Shqipërisë) (Republikës së Moldavisë) në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes në fjalë”.

2. Për këtë qëllim parashikohet si më poshtë:

a) Sigurimi i të dhënave personale:

I) Mbiemri dhe emrat e tjerë;

II) Data e lindjes;

III) Vendlindja dhe shteti;

IV) Adresa e fundit në territorin e shtetit të Palës Kërkuese;

V) Gjinia;

VI) Emri i plotë i babait dhe/ose nënës;

VII) Emrat e mëparshëm;

VIII) Pseudonimi ose alias;

IX) Të dhëna në lidhje me shëndetin, dhe në latinisht emri i ndonjë sëmundjeje ngjitëse nga e cila mund të vuajnë personat që do të kthehen.

b) Kopje e vërtetuar e dokumenteve origjinale që provojnë ose krijojnë presupozimin e shtetësisë të personit që do të kthehet:

I) Dokumentet e identitetit: numri, data dhe vendi i lëshimit, autoriteti që ka lëshuar dokumentin përkatës;

II) Pasaporta: tipi dhe numri, data e lëshimit, autoriteti lëshues dhe vendi ku është lëshuar dokumenti;

III) Çdo dokument tjetër udhëtimi që tregon shtetësinë: emri i dokumentit, numri, data dhe vendi, si dhe autoriteti që e ka lëshuar këtë dokument;

IV) Dokumente të tjera që sigurojnë një mjet të pranimit nga Pala e Kërkuar, të parashikuara sipas nenit 3, paragrafi 2, i Marrëveshjes, për shembull: patenta, certifikata e lindjes etj.

c) 2 fotografi.

d) Për fëmijët duhet të sigurohen të dhënat e mëposhtme:

I) Mbiemri dhe emri (emrat);

II) Mbiemri dhe emri (emrat) e personave që kanë lidhje me fëmijët dhe që Pala Kërkuese është në dijeni;

III) Data e lindjes;

IV) Vendi dhe shteti ku personi ka lindur.

Bashkëlidhur janë:

V) Për fëmijët e lindur në shtetin e Palës Kërkuese, kopja e vërtetuar e certifikatës së lindjes;

VI) Për fëmijët e lindur në një vend të tretë, kopja e vërtetuar e certifikatës së lindjes, nëse është e mundur;

VII) 2 fotografi.

e) Një listë me pikat që argumentojnë dhe/ose krijojnë presupozimin se dokumentet janë siguruar në përputhje me Marrëveshjen.

f) Itinerari i planifikuar, mjetet e transportit, data e ripranimit, pikat e kalimit kufitar.

g) Udhëzime mbi nevojat e policisë për shoqërimin dhe/ose mbikëqyrjen mjekësore kurdoherë që konsiderohet e arsyeshme të ushtrohet; dhe nëse shoqërimi duhet të sigurohet nga autoritetet kompetente të Palës Kërkuese, si

dhe të dhënat e hollësishme të oficerëve që shoqërojnë personin.

h) Një deklaratë që provon se personi në fjalë përmbush kërkesat e nenit 2 të Marrëveshjes.

i) Nënshkrimi i autoriteteve kompetente të Palës Kërkuese.

Neni 4

Përgjigje ndaj kërkesës për ripranimin e vetë qytetarëve

1. Përgjigja ndaj kërkesës për ripranim sipas nenit 2 të Marrëveshjes jepet nga autoriteti kompetent i Palës Kërkuese sipas procedurës dhe brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 7 të Marrëveshjes.

2. Përgjigja që jepet për kërkesën përfshin:

a) Emrin dhe adresën e autoritetit kompetent të Palës Kërkuese, numrin e dosjes dhe datën kur është dhënë përgjigja;

b) Emri dhe adresa e autoritetit kompetent të Palës së Kërkuar;

c) Mbiemri dhe emri (emrat), data e lindjes, vendlindja dhe shteti ku kanë lindur, nëse është e mundur, e personave që do të kthehen;

d) Në rast të aprovimit të kërkesës duhet të jepet edhe konfirmimi se personi që do të kthehet, përmbush dispozitat e nenit 2 të Marrëveshjes;

e) Në rast të mosaprovimit, duhet të jepen argumentet për mospërmbushjen e dispozitave të nenit 2 të Marrëveshjes.

Neni 5

Dokumenti i udhëtimit

1. Autoritetet kompetente të Palës së Kërkuar dërgojnë përgjigjen pozitive në lidhje me kërkesën, përfaqësimit diplomatik ose konsullor të shtetit të Palës Kërkuese, me qëllim lëshimin e një dokumenti udhëtimi, kur kjo çmohet e nevojshme. Bazuar në përgjigjen pozitive të kërkesës, përfaqësimi diplomatik ose konsullor i shtetit të Palës së Kërkuar lëshon një dokument udhëtimi pa vonesë dhe në çdo rast jo më vonë se pesë ditë pas marrjes së përgjigjes pozitive.

2. Dokumenti i udhëtimit është i vlefshëm deri në 30 ditë.

3. Si alternativë ndaj procedurës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, autoritetet e shtetit të Palës Kërkuese mund t'i japin personit në fjalë një dokument udhëtimi standard sipas aneksit të Marrëveshjes.

Neni 6

Aplikimi për ripranimin e të huajve

1. Kërkesa për ripranim sipas nenit 4 të Marrëveshjes duhet të bëhet me shkrim dhe përfshin:

a) Emrin dhe adresën e autoritetit kompetent të Palës Kërkuese, numrin e dosjes dhe datën kur është drejtuar kërkesa;

b) Emrin dhe adresën e autoritetit kompetent të Palës së Kërkuar;

c) Një tekst hyrës, si më poshtë: "Ka arsye që na bëjnë të besojmë se personi i identifikuar si më poshtë mbulohet nga dispozitat e nenit 4 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë mbi ripranimin e personave dhe ne kërkojmë që ky person të pranohet në territorin e (Republikës së Shqipërisë) (Republikës së Moldavisë) në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes në fjalë".

2. Për këtë qëllim, duhet të sigurohen pikat e mëposhtme:

a) Të sigurohen të dhënat personale të disponueshme:

I) Mbiemri dhe emrat e tjerë;

II) Data e lindjes;

III) Vendlindja dhe shteti;

IV) Adresa e fundit në territorin e shtetit të Palës së Kërkuar;

V) Gjinia;

VI) Emri i plotë i babait dhe/ose nënës;

VII) Emrat e mëparshëm;

VIII) Pseudonimi ose alias;

IX) Të dhëna në lidhje me shëndetin dhe në latinisht emri i ndonjë sëmundjeje ngjitëse nga e cila mund të vuajnë personat që do kthehen.

b) Në rast se bëhet aplikim për ripranim sipas nenit 4 të Marrëveshjes, kopje të vërtetuara të dokumenteve origjinale që provojnë/ose krijojnë presupozim të mbajtjes së një vize ose/leje qëndrimi të vlefshme, të lëshuar nga autoritetet e Shtetit të Palës së Kërkuar sipas legjislacionit kombëtar të Palës që do të kthehet si më poshtë:

I) Dokumentet e identitetit që tregojnë një vizë të vlefshme ose dokument qëndrimi: numri, data dhe vendi i lëshimit, autoriteti që ka lëshuar dokumentin;

II) Pasaportë që përfshin vizën e vlefshme/ose lejen e qëndrimit: lloji dhe numri, data e lëshimit, autoriteti lëshues dhe vendi i lëshimit;

III) Dokument tjetër udhëtimi që tregon shtetësinë dhe vizën e vlefshme/ose lejen e qëndrimit: emri i dokumentit, numri, data, vendi ku dokumenti është lëshuar dhe autoriteti që ka lëshuar dokumentin;

c) 2 fotografi;

d) Për fëmijët duhet të sigurohen këto të dhëna:

I) Mbiemri dhe emri (emrat);

II) Mbiemri dhe emri (emrat) e personave që kanë lidhje dhe që Pala Kërkuese është në dijeni;

III) Data e lindjes;

IV) Vendi dhe shteti i lindjes;

Bashkëlidhur do të jenë:

V) Për fëmijët e lindur në shtetin e Palës Kërkuese, kopje e vërtetuar e certifikatës së lindjes;

VI) Për fëmijët e lindur në një vend të tretë, kopje e vërtetuar e certifikatës së lindjes nëse është e mundur;

VII) 2 fotografi.

e) Një listë me pikat që argumentojnë dhe/ose krijojnë presupozimin se dokumentet janë siguruar në përputhje me Marrëveshjen.

f) Itinerari i planifikuar, mjetet e transportit, data e planifikuar për ripranimin, pikat e kalimit kufitar.

g) Udhëzimet mbi nevojat e policisë për shoqërimin dhe/ose mbikëqyrjen mjekësore kurdoherë që konsiderohet e arsyeshme dhe praktike; dhe nëse shoqërimi duhet të sigurohet nga autoritetet kompetente të Palës Kërkuese, si dhe të dhënat e hollësishme të oficerëve që shoqërojnë personin.

h) Një deklaratë me anë të së cilës provohet se personi në fjalë përmbush kërkesat e nenit 4 të Marrëveshjes.

i) Nënshkrimi i autoriteteve kompetente të Palës Kërkuese.

Neni 7

Përgjigje ndaj kërkesës për ripranimin e të huajve

1. Përgjigja për kërkesën për ripranim sipas nenit 4 të Marrëveshjes jepet nga autoriteti kompetent i Palës së Kërkuar për autoritetin kompetent të Palës Kërkuese sipas procedurës dhe brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 7 të Marrëveshjes.

2. Në përgjigjen e kërkesës duhet të përfshihen:

a) Emri dhe adresa e autoritetit kompetent të Palës së Kërkuar, numri i dosjes dhe data kur i është dhënë përgjigje kërkesës;

b) Emri dhe adresa e autoritetit kompetent të Palës së Kërkuar;

c) Mbiemri dhe emri (emrat) i personit që do të kthehet, data e lindjes, vendlindja dhe shteti ku ka lindur, nëse është e mundur; dhe secili

d) Në rast të aprovimit të kërkesës duhet të jepet edhe konfirmimi se personi që do të kthehet, përmbush dispozitat e nenit 4 të Marrëveshjes;

e) Në rast të mosaprovimit, duhet të jepen argumentet për mospërmbushjen e dispozitave të nenit 4 të Marrëveshjes.

Neni 8

Aplikimi për lejimin e kalimit transit

1. Çdo kërkesë për të lejuar kalimin transit sipas nenit 6 të Marrëveshjes bëhet me shkrim dhe përmban:

a) Emrin dhe adresën e autoritetit kompetent të Palës Kërkuese, numrin e dosjes dhe datën kur është bërë kërkesa;

b) Emrin dhe adresën e autoritetit kompetent të Palës së Kërkuar;

c) Një tekst hyrës, si më poshtë: “Ka arsye që na bëjnë të besojmë se personi i identifikuar më poshtë mbulohet nga dispozitat e nenit 6 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë mbi Ripranimin e Personave dhe ne bëjmë kërkesën që transiti i këtij personi përmes territorit të (Republikës së Shqipërisë) (Republikës së Moldavisë) të lejohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes në fjalë”.

2. Për këtë arsye duhet të sigurohen pikat e mëposhtme:

a) Të sigurohen të dhënat personale të disponueshme:

I) Mbiemri dhe emrat e tjerë;

II) Data e lindjes;

III)Vendlindja dhe shteti;

IV)Adresa e fundit në territorin e shtetit të Palës Kërkuese;

V) Gjinia;

VI) Emri i plotë i babait dhe/ose nënës;

VII) Emrat e mëparshëm;

VIII) Pseudonimi ose alias;

IX) Të dhëna në lidhje me shëndetin dhe në latinisht emri i ndonjë sëmundjeje ngjitëse nga e cila mund të vuajnë personat që do të kthehen.

b) Kopje të vërtetuara të dokumenteve origjinale, që provojnë/ose krijojnë presupozimin se i huaji pranohet në një shtet tjetër transit dhe në shtetin e destinacionit.

c) 2 fotografi.

d) Për fëmijët duhet të sigurohen këto të dhëna:

I) Mbiemri dhe emri (emrat);

II) Mbiemri dhe emri (emrat) e personave që kanë lidhje dhe që Pala Kërkuese është në dijeni;

III) Data e lindjes;

IV) Vendi dhe shteti i lindjes;

Bashkëlidhur:

V) Për fëmijët e lindur në shtetin e Palës Kërkuese, kopje e vërtetuar e certifikatës së lindjes;

VI) Për fëmijët e lindur në një vend të tretë, kopje e vërtetuar e certifikatës së lindjes, nëse është e mundur;

VII) 2 fotografi.

e) Itinerari i planifikuar, mjetet e transportit, data dhe ora e kalimit transit të planifikuar nëpërmjet territorit të shtetit të Palës së Kërkuar.

f) Udhëzime mbi nevojat e policisë për shoqërimin dhe/ose mbikëqyrjen mjekësore kurdoherë që arsyetohet e nevojshme dhe praktike; dhe nëse shoqërimi duhet të sigurohet nga autoritetet kompetente të Palës Kërkuese, si dhe të dhënat e hollësishme të oficerëve që shoqërojnë personin.

g) Një deklaratë që provon se personi në fjalë përmbush kërkesat e nenit 6 të Marrëveshjes.

h) Nënshkrimi i autoriteteve kompetente të Palës Kërkuese.

Neni 9

Përgjigja ndaj kërkesës për lejimin e kalimit transit

1. Përgjigja ndaj kërkesës për lejimin e kalimit transit sipas nenit 6 të Marrëveshjes i jepet autoritetit kompetent të Palës Kërkuese nga autoriteti kompetent i Palës së Kërkuar

sipas procedurës dhe brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 7 të Marrëveshjes.

2. Përgjigja ndaj kërkesës përfshin:

a) Emrin dhe adresën e autoritetit kompetent të Palës së Kërkuar, numrin e dosjes dhe datën kur është dhënë përgjigja;

b) Emrin dhe adresën e autoritetit kompetent të Palës së Kërkuar;

c) Mbiemri dhe emrin (emrat) e personit që do të kthehet, datën e lindjes, vendin dhe shtetin e lindjes nëse është e mundur; dhe çdo informacion tjetër;

d) Në rast të aprovimit të kërkesës duhet të jepet konfirmimi se personi që do të kthehet përmbush dispozitat e nenit 6 të Marrëveshjes (duke specifikuar, nëse është e nevojshme, kushtin e lejes për kalimin transit që merret nga i huaji para largimit nga territori i shtetit të Palës Kërkuese, në përputhje me nenin 6 (1) të Marrëveshjes);

e) Në rast të mosaprovimit të kërkesës, të jepen arsyet e mospërmbushjes së dispozitave të nenit 6 të Marrëveshjes.

Neni 10

Procedura e marrjes në dorëzim

1. Autoriteti kompetent i Palës Kërkuese njofton autoritetin kompetent të Palës së Kërkuar për largimin ose nisjen/ose për kalimin transit të personit që do të kthehet nëpërmjet territorit të shtetit të Palës së Kërkuar, të paktën dhjetë ditë para se të planifikohet largimi i tij.

2. Ky njoftim bëhet me shkrim dhe përfshin të dhënat e mëposhtme:

a) Emrin dhe adresën e autoritetit kompetent të Palës Kërkuese, numrin e dosjes dhe datën e njoftimit;

b) Emrin dhe adresën e autoritetit kompetent të Palës Kërkuese;

c) Një tekst hyrës si më poshtë: “Iu njoftojmë se më (data, muaji dhe viti), nga aeroporti, ( ) me fluturimin ( ), koha e nisjes ( ) dhe mbërritja në aeroport ( ), në orën ( ), personi i identifikuar si më poshtë do të kalojë transit përmes (Republikës së Shqipërisë) (Republikës së Moldavisë), në ( ), numri i fluturimit ( ), koha e nisjes ( ), mbërritja në aeroport ( ), në orën ( );

d) Të dhëna për domosdoshmërinë e ndihmës për shkak të sëmundjes ose moshës;

e) Të dhëna nëse mund të ndodhin incidente, me qëllim parashikimin e shoqërimit zyrtar.

Në rast kur autoriteti kompetent i Palës Kërkuese ndodhet përpara pamundësisë së kthimit të personit që duhet të kthehet, sipas njoftimit, ai informon menjëherë me shkrim autoritetin kompetent të Palës së Kërkuar në lidhje me faktin në fjalë.

Neni 11

Pikat e kalimit kufitar

Kthimi i personit sipas Marrëveshjes ndodh në pikat e kalimit kufitar si më poshtë:

a) Në Republikën e Shqipërisë:
Drejtoria për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë
Komisariati për Kufirin dhe Migracionin
Aeroporti ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas
Tel/faks+ 355 4 36 40 28
E- mail: rinas@asp.gov.al

b) Në Republikën e Moldavisë:
Aeroporti Ndërkombëtar Chisinau

Neni 12

Shpenzimet

Shpenzimet e përcaktuara sipas nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje përfshijnë (por nuk kufizohen) shpenzimet e arsyeshme që lidhen me çështjen e dokumenteve të udhëtimit të personit që duhet të kthehet dhe kostot totale të transportit ajror dhe shoqërimit të domosdoshëm. Brenda 30 ditësh, Pala e Kërkuar i dërgon një faturë autoriteteve kompetente të Palës Kërkuese. Të gjitha kostot duhet të paguhen te përfaqësimi diplomatik ose konsullor i shtetit të Palës së Kërkuar çdo muaj para ditës së tridhjetë (30-të) të muajit ku autoritetet kompetente të Palës së Kërkuar e marrin faturën.

Neni 13

Personat e kontaktit

1. Autoritetet kompetente të Palëve njoftojnë brenda tridhjetë ditësh nga nënshkrimi i këtij protokolli, autoritetet kompetente të Palës tjetër emrat e personave të tyre të kontaktit që janë caktuar të trajtojnë çështje praktike që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes dhe për bashkëpunimin e drejtpërdrejtë sipas këtij protokolli.

2. Autoritetet kompetente të Palëve njoftojnë pa vonesë autoritetet kompetente të Palës tjetër mbi ndryshimet e bëra që kanë lidhje me personat e kontaktit.

3. Ndër të tjera, personat e kontaktit kanë si detyrë:

a) Të paraqesin propozimet tek autoritetet kompetente të Palëve me qëllim për të zgjidhur çështjet e mundshme dhe praktike që kanë lindur gjatë zbatimit të Marrëveshjes;

b) T’i bëjnë propozime autoriteteve kompetente të Palëve në lidhje me amendamentet dhe shtesat në Marrëveshje;

c) Të monitorojnë aplikimin e Marrëveshjes;

d) Të përgatisin dhe të rekomandojnë masat e duhura për të luftuar emigracionin e paligjshëm.

4. Palët kanë të drejtë të aprovojnë ose jo propozimet që ngrihen nga personat e kontaktit.

5. Personat e kontaktit duhet të takohen me propozim të njërit prej tyre.

Neni 14
Gjuha e komunikimit

Nëse nuk bihet dakord ndryshe nga Palët, autoritetet kompetente të Palëve do të përdorin gjuhën angleze verbalist dhe me shkrim gjatë zbatimit të Marrëveshjes dhe këtij protokolli.

Neni 15
Dispozitat përfundimtare

Ambasada e Republikës së Shqipërisë e akreditуar në Republikën e Moldavisë dhe Ambasada e Republikës së Moldavisë e akreditуar në Republikën e Shqipërisë, si dhe misioni diplomatik dhe zyrat konsullore të akredituara përkatësisht në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Moldavisë të shteteve Palë.

1. Ky protokoll nënshkruhet për një periudhë të pacaktuar.

2. Ky protokoll do të hyjë në fuqi 30 ditë nga data e njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin Palët Kontraktuese njoftojnë reciprocikisht njëra-tjetrën nëpërmjet rrugëve diplomatike mbi përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të këtij protokolli.

3. Secila Palë Kontraktuese mund të pezullojë tërësisht ose pjesërisht për një periudhë të përcaktuar, zbatimin e këtij protokolli për arsye të mbrojtjes së rendit publik ose shëndetit publik me anë të një njoftimi me shkrim ndaj Palës tjetër Kontraktuese. Pezullimi duhet t'i njoftohet pa vonesë Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet rrugëve diplomatike dhe do të hyjë në fuqi në datën e përcaktuar në njoftim.

4. Secila Palë Kontraktuese mund të propozojë në çdo kohë amendime ose shtesa të këtij protokolli. Pas aprovimit reciprok të amendimeve nga Palët Kontraktuese, ato nënshkruhen në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

5. Secila Palë Kontraktuese mund të denoncojë protokollin, duke i drejtuar njoftimin Palës tjetër Kontraktuese. Protokolli do të pushojë së qeni i vlefshëm ditën e parë të muajit pasardhës nga data në të cilën Pala tjetër Kontraktuese ka marrë njoftimin e denoncimit.

6. Ky protokoll zbatohet për të gjithë personat që kanë hyrë apo qëndrojnë ilegalisht në territorin e Palëve Kontraktuese nga hyrja në fuqi e saj dhe në një kohë të mëpasshme, dhe ata që hyjnë ose qëndrojnë ilegalisht në këto vende do të bëhen të paligjshëm më pas.

7. Anekset e këtij protokolli janë pjesë përbërëse e tij.

Nënshkruar në Bukuresht, më 18.10.2013, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, moldave dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mosmarrëveshjesh në interpretimin e teksteve në gjuhët shqipe dhe moldave, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

ANEKS

Numri i regjistrimit Dok.
Nr.

E vlefshme për një udhëtim nga .....
Deri në .....
Emri .....
Emri i dhënë .....
Data e lindjes ..... Fotografi
Gjatësia .....
Shenja dalluese .....
Shtetësia .....
Adresa në vendin e lindjes (nëse dihet).....
.....
.....

Autoriteti lëshues .....
Lëshuar në (vendi).....
Vula/pulla Lëshuar më (data).....
Nënshkrimi .....

Vërejtje:
.....
.....
.....

VENDIM
Nr. 226, datë 23.4.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës "A", "Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët", shtohet individi i renditur në shkronjën "a" të listës, "Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët.

b) Në fund të shkronjës "C", "Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", shtohen individët e renditur në shkronjën "b", "Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

c) Nga lista e shkronjës "C", "Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", çregjistrohet individi i renditur në shkronjën "c", "Lista e individëve të çregjistruar nga lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR
SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-SË)

A. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME TALIBANËT

a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët";

1. QARI; SAIFULLAH; TOKHI.

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

b) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida";

1. MALIK; MUHAMED; ISHAQ.

2. JABER; ABDALLAH; JABER; AHMAD AL-JALAHMAH.

c) Lista e individëve të çregjistruar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida";

1. YACINE; AHMED; NACER.

Shënim. Gjeneralitet e tjera për personat dhe kompanitë, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM
Nr. 227, datë 23.4.2014

PËR MBYLLJEN E KONSULLATËS SË PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË NJU-JORK DHE HAPJEN E ZYRËS KONSULLORE PRANË MISIONIT TË PËRHERSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA NË NJU-JORK TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Nju-Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

2. Hapjen e Zyrës Konsullore pranë Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

3. Vendimi nr. 585, datë 23.8.2006 i Këshillit të Ministrave, "Për hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të

Republikës së Shqipërisë në Nju-Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës", shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 228, datë 23.4.2014

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS PËR SHËRBIMIN GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8366, datë 2.7.1998, "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar të jetë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Organika e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar të jetë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Numri i punonjësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar të jetë, gjithsej, 133 veta.

4. Vendimi nr. 465, datë 13.2.2013 i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe organikës për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar", shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR (133 punonjës) *Lidhja 1*



Lidhja 2

ORGANIKA E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR

	KATEGORIA	NUMRI
{DREJTORIA E PËRGJITHSHME (28)}		
I. Drejtori i përgjithshëm	II-a	1
II. Zv/drejtor i përgjithshëm dhe drejtor i programim-zhvillimit	II-b	1
3. Sekretare		1
III. DREJTORIA E PROGRAMIM-ZHVILLIMIT	**11**	
1. Sektori i Programimit dhe Publikimeve	**(4)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	3
2. Sektori i Emergjencave dhe Aktivitetit me të Tretët	**(3)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	1
Specialist	IV-b	1
3. Sektori i Arkivit Qendror Teknik të Gjeologjisë	**(4)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	1
Specialist	IV-b	2
IV. DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE	**(14)**	
1. Drejtor	III-a	1
2. Sektori i Financës, Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore	**(3)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	2
3. Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Administratës	**(10)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	1
Specialist	IV-b	2
Magazinier		1
Shoferë të ekspeditave		3
Punonjëse (sanitare)		2
{DREJTORITË E SHËRBIMIT (105)}		
V .DREJTORIA E GJEOINFORMATIZIMIT	**(10)**	
1. Drejtor	III-a	1
2. Sektori i Digjitalizimit	**(5)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	2
Specialist	IV-b	2
3. Sektori i Përpunimit të të Dhënave	**(4)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	2
Specialist	IV-b	1
VI. DREJTORIA E GJEOLOGJISË	**(16)**	
1. Drejtor	III-a	1
2. Sektori i Hartografimit	**(11)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	9
Specialist	IV-b	1
3. Sektori i Gjeomjedisit	**(4)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	2
Specialist	IV-b	1

VII. DREJTORIA E BURIMEVE MINERALE	**(19)**	
1. Drejtor	III-a	1
2. Sektori i Vendburimeve Metalore	**(6)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	5
3. Sektori i Vendburimeve Jometalore	**(6)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	4
Specialist	IV-b	1
4. Sektori i Monitorimit të Lejeve të Kërkim-Zbulimit	**(6)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	4
Specialist	IV-b	1
VIII. DREJTORIA E HIDROKARBUREVE	**(7)**	
1. Drejtor	III-a	1
2. Sektori i Hartografimit	**(3)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	2
3. Sektori i Vendburimeve të Naftës dhe Gazit	**(3)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	1
Specialist	IV-b	1
IX. DREJTORIA E HIDROGJEOLOGJISË	**(16)**	
1. Drejtor	III-a	1
2. Sektori i Ujërave Nëntokësore	**(10)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	7
Specialist	IV-b	2
3. Sektori i Monitorimit të Rrjetit Lumor	**(5)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	2
Specialist	IV-b	2
X. DREJTORIA E GJEOLOGJISË DETARE	**(9)**	
1. Drejtor	III-a	1
2. Sektori i Dinamikës Detare	**(4)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	2
Specialist	IV-b	1
3. Sektori i Shelfit Kontinental	**(4)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	2
Specialist	IV-b	1
XI. DREJTORIA E GJEOLOGJISË INXHINIERIKE, GJEOFIZIKËS DHE GJEODEZISË	**(19)**	
1. Drejtor	III-a	1
2. Sektori i Gjeologjisë Inxhinierike	**(8)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	6
Specialist	IV-b	1
3. Sektori i Gjeofizikës dhe Gjeodezisë	**(7)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	4
Specialist	IV-b	2
4. Sektori i Laboratorit të Vetive Fiziko-Mekanike	**(3)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	1
Specialist	IV-b	1

XII. DREJTORIA E LABORATORIT TË ANALIZAVE KIMIKE	**(9)**	
1. Drejtor	III-a	1
2. Sektori i Analizave të Mineraleve	**(4)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	2
Specialist	IV-b	1
3. Sektori i Analizave të Ujërave	**(4)**	
Përgjegjës sektori	III-a/I	1
Specialist	IV-a	1
Specialist	IV-b	2
PUNONJËS GJITHSEJ	**(133)**	

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E PUNONJËSVE TË SHGJSH SIPAS POZICIONEVE TË PUNËS

I. PUNONJËS ME SISTEMIN PAGË GRUPI + SHTESË PËR POZICION

NR.	**POZICIONI**	**KATEGORIA/KLASA**	**NR. I PUNONJËSVE**
1	DREJTOR I PËRGJITHSHËM	II-a	1
2	ZV/DR. I PËRGJ. E DR. DREJTORIE	II-b	1
3	DREJTOR DREJTORIE	III-a	9
4	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	23
5	SPECIALISTË	IV-a	66
6	SPECIALISTË	IV-b	26
	TOTALI I		**126**

II. PUNONJËS ME SISTEMIN ME KLASA

NR.	**POZICIONI**	**KATEGORIA/KLASA**	**NR. I PUNONJËSVE**
1	SEKRETARE		1
2	MAGAZINIER		1
3	SHOFERË TË EKSPEDITAVE		3
4	SANITARE		2
	TOTALI II		**7**

TOTALI GJITHSEJ I+II **133 PUNONJËS**

VENDIM
Nr. 229, datë 23.4.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR TRANSFERIMIN E MBETJEVE JO TË RREZIKSHME DHE INFORMACIONIT QË DUHET TË PËRFSHIHET NË DOKUMENTIN E TRANSFERIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 11 të nenit 21 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për transferimin në mënyrë profesionale të mbetjeve jo të rrezikshme nga një person te një tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit.

2. Mbetje jo të rrezikshme klasifikohen mbetjet që nuk shënohen me shenjën yll "*", të miratuara me vendimin nr. 99, datë 18.2.2005 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve", të cilit më poshtë i referohemi me emërtimin "Katalogu i mbetjeve".

3. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.

4. Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme bëhet sipas formatit të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme, të përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Dokumenti i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme plotësohet për të gjitha hallkat që ndiqen për transferimin e mbetjeve që nga krijimi deri në destinacionin përfundimtar.

6. Dokumenti i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme plotësohet dhe nënshkruhet nga krijuesi i mbetjeve, grumbulluesi, transportuesi dhe pritësi që merr

në dorëzim mbetjet, sipas aneksit 1 bashkëlidhur, në aq kopje sa janë personat që nënshkruajnë dokumentin.

7. Dokumenti i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme është i vlefshëm edhe në formë elektronike, nëse është i plotësuar dhe i nënshkruar nga personat e përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Përjashtohet nga procedura e zbatimit të këtij vendimi vetëm gjenerimi i mbetjeve shtëpiake.

9. Transporti i mbetjeve jo të rrezikshme bëhet në bazë të kontratës ndërmjet palëve, në të cilën përcaktohet detyrimisht përgjegjësia për rastin e kthimit mbrapsht, pjesërisht ose plotësisht, të mbetjeve nga pritësi, duke plotësuar seksionin C të aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Çdo transfertë e mbetjeve jo të rrezikshme shoqërohet me dokumentin e transferimit të mbetjeve deri në destinacionin përfundimtar dhe të dhënat regjistrohen në Regjistrin e Transfertave Individuale që krijohet për këtë qëllim.

11. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon Regjistrin Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme.

12. Mënyra e administrimit dhe formati i Regjistrit të Transfertave Individuale dhe formati i Regjistrit Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

13. Krijuesi, grumbulluesi dhe pritësi i mbetjeve dërgojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave informacion në lidhje me mbetjet jo të rrezikshme të transferuara, të paktën 1 (një) herë në vit.

14. Dokumenti i transferimit përmban kodin unik, i cili përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë e kodit unik miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim nga personi që transferon mbetjet jo të rrezikshme te pritësi. Kërkesa shoqërohet me kopje të ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

15. Agjencia Kombëtare e Mjedisit miraton pjesën e parë të kodit unik brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

16. Pjesa e parë e kodit unik është individuale dhe e papërsëritshme për çdo subjekt që transferon mbetje jo të rrezikshme, ndërsa pjesa e dytë e këtij kodi vendoset nga vetë personi që transferon mbetjet te pritësi dhe ndryshon për çdo transfertë.

17. Përcaktimi i kodit unik bëhet sipas metodologjisë së dhënë në aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

18. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon një bazë të dhënash për kodet unike, si pjesë të Regjistrit Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme.

19. Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim dhe në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen sipas përcaktimeve të nenit 62 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.

20. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1
FORMATI I DOKUMENTIT TË TRANSFERIMIT TË MBETJEVE JO TË RREZIKSHME

Për t'u përdorur për transferimin vetëm të mbetjeve jo të rrezikshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë

<table>
<tr><td colspan="5">Seksioni A. Krijuesi i mbetjeve/ grumbulluesi/ NJQV/ transportuesi/ agjenti/ tregtari</td></tr>
<tr><td colspan="5">Kodi unik i dokumentit të dorëzimit
(për t'u plotësuar nga krijuesi i mbetjes)</td></tr>
<tr><td colspan="5">1. Cili nga të poshtëshënuarit jeni ju? (zgjidh një ose më shumë kuti)</td></tr>
<tr><td>a. Krijuesi i mbetjeve</td><td></td><td>b. Grumbullues i mbetjeve</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td colspan="3">2. Zotërues i lejes së mjedisit:</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td colspan="2">Tipi i lejes së mjedisit (A, B apo C) e:
Krijuesit
Grumbulluesit</td><td></td><td>a. Numri i lejes së mjedisit e krijuesit
b. Numri i lejes së mjedisit e grumbulluesit</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="3">3. - Emri i personit fizik/juridik që është krijues i mbetjeve (me shkronja të mëdha shtypi)
- Adresa dhe numri NIPT
- Nënshkrimi i personit përgjegjës (emër, mbiemër, firmë)
- Data e nënshkrimit</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td colspan="3">4. - Emri i personit fizik/juridik që është grumbullues i mbetjeve (nëse ka)
- adresa dhe numri NIPT
- nënshkrimi i personit përgjegjës (emër, mbiemër, firmë)
- data e nënshkrimit</td><td colspan="2"></td></tr>
</table>

5. - Emri i personit fizik/juridik që është agjent ose tregtar i mbetjeve (nëse ka) - Adresa dhe numri NIPT - Nënshkrimi i personit përgjegjës (emër, mbiemër, firmë) - Data e nënshkrimit	
6. Transportues i licencuar për mbetjet (nëse ka) (emri i personit fizik/juridik me SHKRONJA TË MËDHA SHTYPI dhe numri NIPT)	
Nëse ka licencë III.2.B, numri i licencës	
Nr. i regjistrimit të automjetit (targa)	
Nënshkrimi i transportuesit	
Data e nisjes	
Ora e nisjes	

Seksioni B. Përshkrimi i mbetjeve (për t'u plotësuar nga krijuesi)											
1. Përshkrimi i mbetjeve:											
2. Kodi i Katalogut Shqiptar të Mbetjeve:											
3. Sasia e mbetjeve (e shprehur në kg ose litër):											
4. Ku ruhen apo magazinohen mbetjet											
Të hapura		Në thasë		Në kosh metalik të hapur		Në kontejner metalik cilindrik		Në cisternë			
Të tjera (lutemi përshkruajini):											
5. Numri i thasëve, kontejnerëve, koshave, cisternave e të tjera:											
6. Pesha e thasëve, kontejnerëve, koshave, cisternave e të tjera:											

Seksioni C. Personi që merr në dorëzim mbetjet (pritësi)			
1. Emri i plotë (SHKRONJA TË MËDHA SHTYPI)			
2. Emri - adresa dhe numri NIPT i kompanisë			
3. Tipi i lejes së mjedisit (A, B apo C):		Numri i lejes së mjedisit	
4. Nr. i licencës III.2.B			
4. Nënshkrimi i pritësit (emër, mbiemër, firmë)			
5. Data e marrjes në dorëzim			
6. Për t'u plotësuar nga pritësi në rast refuzimi të pjesshëm ose të plotë të mbetjeve			
Arsyet e refuzimit:			
Kodi i mbetjes së refuzuar sipas Katalogut të Mbetjeve Sasia e mbetjes/eve të refuzuar			
Data e refuzimit dhe nënshkrimi (emër, mbiemër, firmë)			
7. Për t'u plotësuar nga personi që merr mbrapsht mbetjet e refuzuara (krijuesi/ grumbulluesi/ tregtari/ agjenti)			
Data dhe ora e marrjes në dorëzim të mbetjeve të refuzuara			
Nënshkrimi (emër, mbiemër, firmë)			
Seksioni D. Destinacioni i mbetjeve (për t'u plotësuar nga pritësi)			
1. A shkojnë mbetjet për: (plotësoni vetëm një kuti)			
Rikuperim (jepni numrin R nga aneksi II i ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"			
Lendfill (D 5)			
Incinerim (D 10)			
Operacione të tjera asgjësimi (jepni numrin D nga aneksi I i ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"			

Seksioni C. Deklarata e paratrajtimit (për t'u plotësuar nga pritësi)									
VKM nr. 452, datë 11.7.2012, "Për lendfillin e mbetjeve", përcakton trajtimin, si: proces fizik, termik apo biologjik (përfshirë seleksionimin) që ndryshon karakteristikat e mbetjeve me qëllim pakësimin e vëllimit apo natyrës së rrezikshme të tyre, lehtëson trajtimin apo rrit rikuperimin e tyre. Pjesa C plotësohet vetëm në rastet kur mbetjet asgjësohen në lendfill.									
1. Cilat materiale janë veçuar nga këto mbetje (vendosni shenjën √ në kutitë e duhura)?									
Letër		Karton		Metale		Qelq		Plastikë	
Dru		Ushqim		Të kompostueshme		Mbetje nga pajisje elektrike, elektronike		Bateri	
Të tjera									
2. Cila është përqindja e vëllimit origjinal total të mbetjeve që janë asgjësuar?									
Më pak se 5%				5% deri në 25%					

25% deri në 50%		50% deri në 75%		Më shumë se 75%	
Cilat procese janë përdorur për të ndarë apo trajtuar këto mbetje apo informacione të tjera që mund të ndihmojnë në trajtimin apo asgjësimin e mbetjeve. Nëse mbetjet nuk janë trajtuar, lutemi deklaroni përse:					

Seksioni D. Vendi i transferimit	
1. Adresa e vendit të transferimit/pikës së grumbullimit:	
2. Data e transferimit:	
3. Koha e transferimit (për transferimet e shumëfishta, jepni datat e ndërmjetme)	

ANEKSI 2
METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË KODIT UNIK TË DOKUMENTIT TË TRANSFERIMIT

Kodi unik i dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme përbëhet nga dy pjesë.

A. Pjesa e parë e kodit unik përmban 7 karaktere, nga të cilat 3 të parat janë shkronja dhe pjesa tjetër janë numra natyrorë. 3 shkronjat e para janë inicialet e personit fizik ose juridik ose akronimi i emrit të subjektit. 4 numrat fillojnë me 0001 për subjektin që kërkon i pari pajisjen me kodin unik. Më pas vazhdohet me vendosjen e numrave në rend rritës: 0002; 0003; e në vazhdim.

Shembuj:

a) Nëse personi i parë që kërkon pranë AKM-së të pajiset me kodin unik është Elmaz Kujtim Latifi, pjesa e parë e kodit unik do të jetë: EKL0001.

b) Nëse personi i dytë, që kërkon pranë AKM-së të pajiset me kodin unik, është subjekti General Equipments Albania, pjesa e parë e kodit unik do të jetë: GEA0001.

B. Pjesa e dytë e kodit unik përmban 4 numra, nga të cilët, 2 numrat e parë tregojnë vitin në të cilin kryhet transferta dhe 2 numrat e tjerë tregojnë numrin e transfertës që po kryhet. Pjesa e dytë e kodit unik vendoset nga vetë transferuesi i mbetjeve.

Shembuj:

Nëse person i shembullit "a" më lart transferon mbetjet në datën xx.xx.2014 dhe është transferta e parë për vitin kalendarik 2014, pjesa e dytë e kodit unik do të jetë: 1401. Kodi unik në këtë rast do të jetë: EKL00011**01**.

Nëse person i shembullit "a" më lart transferon mbetjet në datën xx.xx.2014 dhe është transferta e dytë për vitin kalendarik 2014, pjesa e dytë e kodit unik do të jetë: 1402. Kodi unik në këtë rast do të jetë: EKL00011**02**.

Nëse person i shembullit "b" më lart transferon mbetjet në datën xx.xx.2015 dhe është transferta e parë për vitin kalendarik 2015, pjesa e dytë e kodit unik do të jetë: 1501. Kodi unik në këtë rast do të jetë: GEA00011**01**.

Nëse person i shembullit "b" më lart transferon mbetjet në datën xx.xx.2015 dhe është transferta e dytë për vitin kalendarik 2015, pjesa e dytë e kodit unik do të jetë: 1502. Kodi unik në këtë rast do të jetë: GEA00011**02**.

VENDIM
Nr. 230, datë 23.4.2014

PËR PËRBËRJEN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË SEKRETARIATIT TEKNIK TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 1, shkronja "b" e 11 të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, si organ ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Ujit, është institucion juridik publik, me seli në Tiranë.

2. Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, si një nga organet kombëtare të administrimit dhe të menaxhimit të burimeve ujore, ka objekt të veprimtarisë së tij projektimin dhe ngritjen e sistemit total të integruar të ujit dhe monitorimin e garantimin e funksionimit efikas të menaxhimit të integruar të këtij sistemi.

3. Funksionet dhe kompetencat e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit janë ato të përcaktuara në ligjin nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".

4. Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit financohet nga buxheti i shtetit dhe nga çdo burim tjetër financiar i ligjshëm.

5. Drejtuesi i Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të Kryeministrit, në cilësinë e kryetarit të Këshillit Kombëtar të Ujit.

6. Rregullorja e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit miratohet nga Këshilli Kombëtar i Ujit, sipas përcaktimeve të shkronjës "d", të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2012.

7. Vendimi nr. 910, datë 30.12.1996 i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit", shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 231, datë 23.4.2014

PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PRAKTIKANTËVE PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS PROFESIONALE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR PERIUDHËN 1 JANAR - 15 QERSHOR 2014 DHE 15 SHTATOR 2014 - 31 DHJETOR 2014, PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 57 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2013-2014, për periudhën 1 janar - 15 qershor 2014 dhe periudhën 15 shtator 2014 - 31 dhjetor 2014, të jetë 1 500 veta.

2. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme sipas drejtorive arsimore rajonale/zyrave arsimore dhe afati kohor i kontraktimit të punonjësve jepen sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Praktikantët, gjatë periudhës së kryerjes të praktikës profesionale, përfitojnë çdo muaj nga punëdhënësi, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7%, të përllogaritur mbi pagën bazë minimale mujore 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë, miratuar me vendimin nr. 573, datë 3.7.2013 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

Ndryshimet e pagës minimale mujore, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, reflektohen në masën e pagesës që punëdhënësi paguan çdo muaj për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

4. Efektet financiare për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2014, në shumën 49 599 000 (dyzet e nëntë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në buxhetin e vitit 2014.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
TABELA NR. 1

Kodi i institucionit	Emërtimi i institucionit arsimor	Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme sipas drejtorive arsimore	Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme sipas drejtorive arsimorë
1011002	Drejtoria Arsimore Rajonale	59	59
1011006	Drejtoria Arsimore Rajonale	43	43
1011007	Drejtoria Arsimore Rajonale	83	83
1011008	Drejtoria Arsimore Rajonale	105	105
1011009	Drejtoria Arsimore Rajonale	83	83
1011011	Drejtoria Arsimore Rajonale	24	24
1011015	Drejtoria Arsimore Rajonale	69	69
1011018	Drejtoria Arsimore Rajonale	37	37
1011020	Drejtoria Arsimore Rajonale	37	37
1011033	Drejtoria Arsimore Rajonale	88	88
1011035	Drejtoria Arsimore e Qytetit	153	153
1011036	Drejtoria Arsimore e Qarkut	61	61
1011038	Drejtoria Arsimore Rajonale	75	75
1011088	Zyra Arsimore Kuçovë	16	16
1011089	Zyra Arsimore Skrapar	15	15
1011090	Zyra Arsimore Bulqizë	18	18
1011092	Zyra Arsimore Mat	32	32
1011096	Zyra Arsimore Krujë	30	30

1011100	Zyra Arsimore Gramsh	22	22
1011101	Zyra Arsimore Librazhd	39	39
1011102	Zyra Arsimore Peqin	15	15
1011105	Zyra Arsimore Lushnjë	66	66
1011106	Zyra Arsimore Mallakastër	17	17
1011109	Zyra Arsimore Përmet	14	14
1011110	Zyra Arsimore Tepelenë	21	21
1011111	Zyra Arsimore Devoll	15	15
1011112	Zyra Arsimore Kolonjë	9	9
1011117	Zyra Arsimore Pogradec	37	37
1011118	Zyra Arsimore Has	10	10
1011120	Zyra Arsimore Tropojë	18	18
1011121	Zyra Arsimore Kurbin	27	27
1011123	Zyra Arsimore Mirditë	18	18
1011124	Zyra Arsimore Malësia e Madhe	20	20
1011125	Zyra Arsimore Pukë	18	18
1011130	Zyra Arsimore Kavajë	36	36
1011132	Zyra Arsimore Delvinë	8	8
1011133	Zyra Arsimore Sarandë	16	16
1011159	Zyra Arsimore Kamzë	46	46
	TOTALI	**1500**	**1500**

VENDIM
Nr. 232, datë 23.4.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 945, DATË 9.10.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË MJEDISIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika V e vendimit nr. 945, datë 9.10.2013 të Këshilli të Ministrave, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 234, datë 23.4.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 239, DATË 27.3.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË RE TË PËRDORIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANTET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit nr. 239, datë 27.3.2013 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Fondet kundërparti, të dhëna nga qeveria japoneze dhe të mbledhura nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, si agjenci e pagesave, në shumën 116 350 000 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të trajtohen si të ardhura jashtë limitit dhe të përdoren nëpërmjet llogarisë së thesarit brenda vitit 2014".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 239, datë 28.4.2014

PËR SHLYERJEN E DETYRIMIT DOGANOR TË PRAPAMBETUR TË MINISTRISË SË MBROJTJES NDAJ DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr. 185/2013 "Për buxhetin e vitit 2014" dhe të vendimit nr. 50, datë 5.2.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shlyerjen e detyrimit doganor të prapambetur të Ministrisë së Mbrojtjes ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për vitin 2013, në shumën 478 714 581 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind e katërmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë, deklaruar në listën e detyrimeve për artikullin 231, shpenzime kapitale për TVSH-në e papaguar.

2. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga zëri "Detyrime të prapambetura", të planifikuara në buxhetin e vitit 2014.

3. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 28 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006